


Aksidentet Rrugore

Prill 2023

Tiranë, më 18 Maj 2023 : Në muajin Prill 2023 numërohen 69 aksidente rrugore nga 92 të ndodhura në muajin Prill 2022. Numri i aksidenteve rrugore është ulur me 25,0 %.

Fig. 1 Aksidentet rrugore dhe të aksidentuarit (të vrarë e të plagosur), Prill 2019 – Prill 2023




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) rezulton 94 persona nga 132 në muajin Prill 2022.

Aksidentet rrugore, në 87,0 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha deri 24 vjeç, duke zënë 24,6 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup-moshë janë ulur me 15,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Prill 2023, numri më i lartë i aksidenteve rrugore ka ndodhur ditët e Shtuna dhe të Diela, ndërsa numri më i ulët i aksidenteve ka ndodhur të Enjteve.


Fig. 2 Aksidentet rrugore sipas ditëve të javës në %, Prill 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në muajin Prill 2023, 24,6 % e aksidenteve rrugore kanë ndodhur gjatë harkut kohor 14:00-17:00.

Fig. 3 Aksidentet rrugore sipas orës së ndodhjes në %, Prill 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në katërmujorin e parë të vitit 2023, numërohen 332 aksidente rrugore nga 377 aksidente, të ndodhura në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i aksidenteve rrugore është ulur me 11,9 %.

Numri i të aksidentuarve është 454 persona nga 524 persona të aksidentuar në katërmujorin e parë të vitit 2022.

Aksidentet rrugore, në 18,1 % të rasteve, në katërmujorin e parë të vitit 2023 kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit për periudhën katërmujore është rritur me 20,0 %.

Tab. 1 Aksidentet rrugore dhe numri i të aksidentuarve sipas gjinisë

Periudha	Aksidente	Të vdekur dhe të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Prill 2022	92	42	90
Prill 2023	69	26	68
Ndryshimi vjetor (%)	-25,0	-38,1	-24,4
Janar-Prill 2022	377	149	375
Janar-Prill 2023	332	141	313
Ndryshimi vjetor (%)	-11,9	-5,4	-16,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Aksidentet rrugore sipas përdoruesve të rrugës

Periudha	Aksidentet sipas		Të vdekur dhe të plagosur	
	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit
Prill 2022	78	14	118	14
Prill 2023	60	9	83	11
Ndryshimi vjetor (%)	-23,1	-35,7	-29,7	-21,4
Janar-Prill 2022	327	50	468	56
Janar-Prill 2023	272	60	390	64
Ndryshimi vjetor (%)	-16,8	20,0	-16,7	14,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Aksidentet rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	0 - 24 vjeç	25- 34 vjeç	35- 44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Prill 2022	20	21	10	22	9	10
Prill 2023	17	16	14	12	9	1
Ndryshimi vjetor (%)	-15,0	-23,8	40,0	-45,5	0,0	-90,0
Janar-Prill 2022	75	97	72	74	34	25
Janar-Prill 2023	66	90	66	60	41	9
Ndryshimi vjetor (%)	-12,0	-7,2	-8,3	-18,9	20,6	-64,0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Aksidentet rrugore, numri i të vdekurve dhe plagosurve sipas qarqeve

Periudha	Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur		Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur	
	Prill 2022	Prill 2023	Prill 2022	Prill 2023	Janar-Prill 2022	Janar-Prill 2023	Janar-Prill 2022	Janar-Prill 2023
Shqipëria	92	69	132	94	377	332	524	454
Berat	0	2	0	4	10	10	17	12
Dibër	0	0	0	0	3	6	5	12
Durrës	7	7	15	11	25	48	47	69
Elbasan	2	3	2	7	9	12	13	16
Fier	6	5	6	6	24	17	31	24
Gjirokastrë	6	3	11	4	22	14	40	22
Korçë	5	2	7	5	18	11	23	15
Kukës	5	0	5	0	20	11	29	18
Lezhë	11	8	17	11	41	24	61	38
Shkodër	0	1	0	1	9	5	17	7
Tiranë	46	34	65	41	183	162	222	208
Vlorë	4	4	4	4	13	12	19	13

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve rrugore është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimi në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

I vdekur: Çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, përjashtuar vetëvrasjet.

I plagosur: Çdo person i cili si rezultat i një aksidenti nuk u vra menjëherë ose nuk vdiq brenda 30 ditësh, por pësoi një dëmtim për të cilin lind nevoja e një trajtimi mjekësor, duke përjashtuar vetëvrasjet në përpjekje.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

- 0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse
- pa vlerë
- (...) mungesë të dhënash